

KUPTIMI, SIMBOLIKA DHE ESTETIKA E ELEMENTEVE PARATEKSTORE NË ROMANET E REXHEP QOSJES

Shefkije ISLAMAJ

Abstrakt

Për poetikën e romaneve të Rexhep Qosjes, rëndësi të veçantë kanë, pos analizës gjuhësore- stilistike, edhe analiza e tekstit - stilistika tekstore, dhe analiza e ligjëritimit - stilistika diskursive.

Duke qenë se romanet e Rexhep Qosjes janë cilësuar si romane moderne dhe postmoderne, është e vetëkuptueshme se ato japin lëndë të pasur gjuhësore e letrare për studimin e një vargu çështjesh në rrafshin tekstor dhe ligjërimor.

Në këtë kumtesë, elementet paratekstore (titujt, nëntitujt e motot e romaneve) dhe kontekstualizimi i tyre, do të trajtohen nga aspekti kuptimor, gjuhësor dhe stilistik me qëllim zbulimi të veçorive tipike moderne e postmoderne të prozës artistike të Rexhep Qosjes.

Ministraturat letrare, si shënjeshtë të dalluar stilistikë, si tekste rrëfimi, si pozicione të fuqishme të tekstit ose si nyja mendimore e stilistike të tekstit, siç janë edhe titujt, nëntitujt dhe motot e romaneve të Rexhep Qosjes, kanë edhe funksion poetik dhe metagjuhësor. Ata i paraprijnë tekstit dhe konsiderohen si paratekst i domosdoshëm, janë shënjeshtë e parë me të cilët takohet lexuesi dhe krijon përshtypjen e parë lidhur me tekstin letrar në tërësi. Kështu titujt e romaneve të tij “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, “Një dashuri dhe shtatë faje”, “Bijtë e askujt” I, II, “Nata është dita jonë”, “Të fshehtat e treguara” dhe novela “I ringjalluri i penduar” paraqesin interes për analiza stilistike, me qëllim zbulimi të funksionit të tyre referencial, funksionit konotativ, funksionit ekspresiv, funksionin simbolik dhe funksionit informues.

Romanet e Rexhep Qosjes japin lëndë të pasur gjuhësore e letrare për studimin e çështjeve të shumta e të llojllojshme në rrafshin tekstor dhe ligjërimor. Në këtë rrafsh me rëndësi janë edhe të ashtuquajturat elemente paratekstore. Fjala është për titujt, nëntitujt dhe motot, si elementet paratekstore si pozicione të fuqishme ose si nyja mendimore e stilistike të tekstit. Kontekstualizimi i tyre dëshmon karakterin e romaneve të tij moderne, në të vërtetë për prirjen e tyre nismëtare postmoderne në letërsinë shqipe.

Parateksti qëndron midis tekstit dhe kontekstit, në të vërtetë ai paraqet kufirin a skajin e tekstit midis asaj ta quajmë të brendshmes dhe asaj të jashtmes, një si “zonë e papërcaktuar”, pa kufij të prerë midis tekstit dhe kontekstit. Elementet që funksionojnë si paratekste, sipas shënjeshtëve të tyre, nuk mund të konsiderohen si tekste rrëfimi, sipas Zherard Zhenetit¹, sepse nuk kanë shënjeshtë strukturorë siç i kanë tekstet rrëfimtare. Kufijtë midis veprës në tërësi dhe tekstit i ka përcaktuar qartë pikërisht Zheneti, duke u mbështetur në pikëpamjet e mëhershme të Roland Bartit se “teksti është pjesë e librit” dhe se “teksti rrallë lexohet dhe interpretohet jashtë tërësisë së tij”².

Elementet paratekstore të tekstit letrar quhen nga studiuesit e stilistikës diskursive edhe si *pozicione të fuqishme të tekstit*³. Ato janë “nyja” mendimore e stilistike të tekstit, të cilat sipas pozicionit që kanë në tekst dhe sipas formës së tyre kanë rëndësi të madhe për ta kuptuar tekstin letrar. Këto nyja a segmente mbahen mend më shumë se pjesët e tjera të tekstit.

¹ Sipas Ivana Buljubašić, *Pojam parateksta Gérarda Genettea u okviru suvremene naratologije*, në revistën “Anafora” - časopis za znanost o književnosti, Filozofski fakultet, Sveučilište Josipa Jurja Strossmayera, Osijek, nr. 4. 2017, f. 5-35.

² Roland Barthes, *Uvod u strukturalnu analizu pripovjednih tekstova*, në “Suvremena teorija pripovijedanja”, Vladimir Biti, “Globus”, Zagreb, 1992, f. 47-78.

³ Marina Katnić-Bakaršić, *Lingvistička stilistika*, Open Society Institute Center for Publishing Development, Elektronic Publishing Program H-1051 Budapest, Hungary w.w.w.osi.hu/ep, f. 98.

Si pozicione të fuqishme të tekstit letrar të Rexhep Qosjes konsiderohen jo vetëm titujt, nëntitujt e motot e romaneve, po edhe fillimet dhe përfundimet e paragrafëve ose të krerëve, në kuptimin e ngushtë edhe figurat stilistike, tropet, frazemat, togfjalëshat, fjalët e urta, shprehjet aforistike, citatet, emrat e përveçëm, e të tjera.

Titujt, si elemente strukturore paratekstore janë elementet metanarrative që, si për semantikën ashtu edhe për formën e tyre, bien në sy më së shumti në romanet e Rexhep Qosjes, por edhe në të gjitha veprat e tij llojesh të ndryshme. Si shënjeshtë të dalluar stilistikë, titujt kanë edhe funksion poetik dhe metagjuhësor, për çka janë kthyer në pozicione të fuqishme dytësore. Ata i paraprijnë tekstit dhe konsiderohen si paratekst i domosdoshëm. Janë shënjeshtet e parë me të cilët takohet lexuesi dhe krijon përshtypjen e parë lidhur me tekstin letrar në tërësi. Kështu titujt e romaneve të tij “Vdekja më vjen prej syve të tillë” (1974), “Një dashuri dhe shtatë faje” (2003), “Bijtë e askujt” (2010), “Nata është dita jonë” (2007), “Të fshehtat e treguara” dhe novela “I ringjalluri i penduar” (2002), paraqesin interes për analiza stilistike, me qëllim zbulimi të funksionit të tyre referencial, funksionit konotativ dhe funksionit ekspresiv. Ata shprehin në mënyrë të ngjeshur e simbolike informacionin bazë për përmbajtjen e tyre, në të vërtetë ata janë përmbajtje e shkurtër e romanit, një si minipërmbajtje, pranadaj konsiderohet mesazh, informatë, përfundim, por edhe kufizues dhe vend i përcaktimit të tekstit.

“Një dashuri dhe shtatë faje” 1983, “Bijtë e askujt” I, II, 2010, “Nata është dita jonë” 2017, “Të fshehtat e treguara” 2020, i novelës satirë “I ringjalluri i penduar” 2002,

Siç shihet, shkrimtari Rexhep Qosja, ashtu siç ka shprehur kujdes të madh në përzgjedhjen gjuhësore e stilistike, ka përzgjedhur me shumë kujdes edhe titujt, nëntitujt e motot e romaneve. Me titujt e lartpërmendur shkrimtari ka treguar se është i vetëdijshëm për rëndësinë që ka titulli për domethënien dhe receptimin e veprës letrare e shkencore në përgjithësi. Çdo lexues i romaneve të tij kur mbyll faqen e fundit të romanit, ka përshtypjen se e ka parandier përmbajtjen dhe përfundimin e romanit që ka krijuar pikërisht nga titulli i tij, që do të thotë se lexuesi ka filluar zbulimin e romanit jo nga leximi i faqeve të para, por nga titulli i romanit, që do të thotë se ai, që nga titulli, është bërë lexues aktiv dhe është përgatitur për të “zotëruar” modelin e botës së jashtme dhe të asaj të brendshme, që na e ofron shkrimtari me veprën e tij..

Funksione të tilla kanë edhe *nëntitujt* e *mbititujt*, të cilët saktësojnë dhe përcaktojnë në mënyrë më të përshtatshme e më të plotë përmbajtjen e tekstit, duke shërbyer edhe si plotësim i titullit, prandaj thuhet “nëse titulli është *mbitekst*, atëherë nëntitulli është një lloj mbimbiteksti”⁴. Edhe qëllimi i nëntitujve, si minitituj, si tituj shtesë, është të ndihmojnë të kuptuarit e teksteve letrare që mbulojnë ata dhe të tërheqin vëmendjen e lexuesit. Edhe këto qëllime të nëntitujve përmbushen mirë në romanet e Rexhep Qosjes.

Titujt e romaneve të Qosjes janë të përbërë e të thjeshtë nga struktura, por shquajnë për shumëkuptimësinë dhe figurshmërinë e tyre të lartë. Ajo që i shquan ata janë: simbolika, ngjeshja semantike, thjeshtësia, fuqia tërheqëse mbamendja, konkretësia, vlerësia dhe mbulimi i përmbajtjeve të tyre. Ata zbulojnë dhe sugjerojnë qartë semantikën e romaneve që emërtojnë. Siç dihet, “teksti letrar-artistik konceptohet e kuptohet si tërësi, kurse çdo pjesë e tij zbulon semantikën e vet vetëm në raport me tërësinë.”⁵ Në këtë kontekst titujt e këtyre romaneve mbulojnë kuptimisht dhe simbolikisht tërësinë e tyre, ashtu si nëntitujt që mbulojnë minitërësitë semantike të romaneve. Dhe, ashtu me mbulimin e këtyre minitërësive pashmangshëm mbulojnë kuptimisht e simbolikisht edhe tërësinë e tyre, domethënë mbulojnë veprën në tërësi. Shkrimtari Rexhep Qosja është i vetëdijshëm se takimi i parë i receptuesit me titullin është shumë i rëndësishëm dhe shumë shpesh është takim vendimtar për leximin e mëtejshëm të romanit, prandaj titujt e romaneve të tij janë jo vetëm tekste të ngjeshura e të përbëra prej elementeve sintaksore të shënjuara, por edhe tekste provokuese, konkrete, të shumëkuptimshme, ekspresive, stilogjene, ndërsa pesha e tyre konotative dhe referenciale është

⁴ Marina Katnić-Bakaršić, Po aty, f. 98.

⁵ J. M. Lotman, *Predavanja iz strukturalne poetike*, Zavod za izdavanje udžbenika, Sarajevë, 1970, f. 242.

shndërruar në funksion poetik. Kështu, fjala vjen, kryetitulli i romanit “Nata është dita jonë” nuk mund të shihet vetëm si fjali sipas strukturës dhe funksionit ose vetëm si njësi semantiko-stilistike, por edhe si sintaksostileme me shënjes funksionalë-stilistikë dhe me ngjyrim të theksuar shprehës, me shënjes simbolikë dhe aludim, me çka përfshihen të dy anët e titullit: sintaksa dhe stilistika e tij. Ky dhe titujt e tjerë të tij janë posaçërisht të ngarkuar me aluzione që kanë karakter ndërtekstor. Mund të thuhet, prandaj, se titujt e romaneve të Rexhep Qosjes nuk janë vetëm bosht tekstor, por edhe skelet i fortë i tekstit, pavarësisht përkatësisë së tyre funksionalo-stilistike.

Çdo tekst ka dy nivele interpretimi: nivelin horizontal dhe nivelin vertikal. **I pari** lidh shkrimtarin me lexuesin, kurse **i dyti** lidh tekstin me tekstet e tjera, në të vërtetë çdo tekst mbindërton ndërtekst, në vargun e teksteve tashmë të shkruara dhe të atyre që do të shkruhen, duke sugjeruar me shënjesuesit e tij tekste të tjera. Po kështu, koncepti i ndërtekstorisë sot shihet në raport me hipertekstin si dhe me teorinë e veprës së hapur të Umberto Ekos. Ashtu siç mund të lexohet çdo vepër artistike në disa mënyra, gjithnjë sipas Ekos, ashtu siç mund të përkufizohet universumi në shumë mënyra⁶, mendoj se ashtu mund të lexohen, kuptohen, paragjykojnë dhe interpretohen edhe titujt e nëntitujt e romaneve të Rexhep Qosjes.

Të gjithë titujt e romaneve të tij “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, “Një dashuri dhe shtatë faje”, “Bijtë e askujt” I, II, “Nata është dita jonë”, “Të fshehtat e treguara” dhe novela “I ringjalluri i penduar” mund të kuptohen në disa mënyra. Mund të kuptohen si:

1. Tituj me shtresë simbolike

Në romanet e Rexhep Qosjes shquajmë mundësi dhe arritje të madhe simbolike. Simbolet e tij mund t’i njohim nëse arrijmë të kuptojmë marrëdhëniet dhe rendin midis tyre. Burimi i tyre lidhet me sistemin simbolik të botës shqiptare, por edhe me sistemin simbolik të qytetërimit botëror. Simbolika e romaneve të tij zbulon vlera universale, që fshihen edhe në detaje të shumta që përbëjnë përvojën njerëzore dhe përfshihen edhe në titujt, nëntitujt dhe në motot, të cilat sugjerojnë ide të fshehta e përmbajtje të thella filozofike e mitologjike. Këto simbole kanë dy njëmendësi: shprehjen konkrete brenda kufijve të një tërësie, siç është romani, dhe interpretimin e kuptimin e vërtetë të asaj shprehjeje, domethënë funksionin e saj brenda kësaj tërësie. Këto simbole kanë pikëqendër këta dualizma: vdekja përballë jetës, dhuna përballë lirisë dhe anasjelltas, dashuria përballë ndarjes e vdekjes, të cilat figurojnë në rrjedhën e të gjitha romaneve të Rexhep Qosjes, si kufij të ndarjes së tyre, më së pari të sistemeve ideologjike e më pas edhe si pika përthyerjeje në jetën individuale të personazheve, të cilat ekzistencën e tyre vetjake dhe profesionale e ndajnë jo vetëm në të sotmen dhe në të shkuarën, por edhe në gjithë hapësirën gjeografike shqiptare.

Personazheve kryesore të romaneve të Rexhep Qosjes “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, “Një dashuri dhe shtatë faje” dhe “Bijtë e askujt”, madje edhe të romanit “Të fshehtat e treguara” vdekja u rri ose përballë ose në krah, prandaj, me të lexuar titullin e romanit të parë “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, lexuesi pashmangshëm do të shtrojë pyetjen se të kujt janë ata sy që ndjellin aq frikë e aq ankth, që aq tmerrshëm sjellin mortje, vdekje. Çka simbolizon ai shikim aq vdekjendjellës? Lexuesit, kështu, i krijohen, pos kureshtjes, edhe mëdyshje e mundësi për të kuptuar simbolikën e këtij titulli. Përgjigjen mund ta ndihmojë vargu i famshëm i Çezare Pavезes: “për gjithsecilin vdekja ka shikim”, nxjerrë nga poezia e tij e njohur “Do të vijë vdekja dhe do të ketë sytë tu”. Së këndejmi simbolika e titullit të romanit në fjalë të Rexhep Qosjes është polisemike me bosht kuptimor vdekjen dhe e mbështetur në shprehjen e figurshme të shqipes *shoh (e pashë) vdekjen me sy*, që ndeshet pothuajse në të gjitha gjuhët e botës, që shprehet edhe në të vërtetën tjetër a në kuptimin e aforizmit të shkrimtarit e mendimtarit francez, autorit të memoareve e të shumë aforizmave, La Roshfukos: “As diellin e as vdekjen nuk duhet

⁶ Umberto Eco, *Otvoreno djelo*, “Veselin Masleša”, Sarajevë, 1965, f. 317.

ta shikojmë në sy”. Megjithëse ka një bazë vërtetësie në këtë mendim, përdallimi ekziston: të shikosh diellin mund të jetë e rrezikshme për sytë, por të shikosh patrembshëm vdekjen në sy ka kuptim e mesazh tjetër: ose do ta mundësh ose do të të mundë. Fati i personazhit Xhezairi i Gjikhës është tragjik – ata sy mund të jenë të Danjollit të Sherkes në “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, ose të Sylejman Akjanit, shkaktarit të vdekjes së Hana Ujëmiri në “Një dashuri dhe shtatë faje”, ose të Budin Budës – Kentaurit, autorit të shumë viktimave të dhunës e krimeve të tjera në “Nata është dita jonë”, ose të vdekjes së tmerrshme të Tarik Saraçit në kufirin vdekjendjellës që ka ndarë shqiptarët padrejtësisht në romanin “Bijtë e askujt”, ose vrasësit që shkakton vdekjen e dhembshme e absurde të Delina Dertit, po kështu në romanin “Bijtë e askujt”, ose shkaktarit a shkaktarëve të emigrimit misterioz fizik e metafizik të Bardh Dynjasë në romanin “Të fshehtat e treguara”, por edhe të parehatisë së tejbotshme të Skënderbeut, që do t’u fanitet shpesh shqiptarëve për arsye të harresës së amanetit të tij, në novelën “I ringjalluri i penduar”.

Xhezairi i Gjikhës, si edhe sivëllezërit e tij në romanet e tjera të autorit, e ka ditur se ata sy sjellin vdekjen, ai e ka njohur vdekjen që mund ta sillnin ata sy, sepse shumë paraardhës të tij dhe shumë bashkëkohës të tij i kanë parë, përjetuar, njohur e ndier ata sy dhe vdekjet që sjellin ata sy. Dhe ai i ka ditur e njohur së afërmi e së largu prandaj ata, sepse, siç thotë Gëteja: “Të gjithë ne dimë shumëçka për vdekjen, por kur ajo ndodh, ne e shpjegojmë si diçka më të pabesueshmen e më të papriturën. Kjo është pothuajse e pamundur, por që papritur bëhet njëmendësi.”

Aktualizimi i simboleve në një vepër letrare ashtu si edhe interpretimi i simbolikës së titujve dhe nëntitujve të saj, rrjedhimisht edhe të romaneve të Rexhep Qosjes, kërkon njohje të thellë të botës, prandaj lexuesi i romaneve të tij duhet të jetë lexues i përgatitur me dije e me intuitë gjuhësore-letrare, domethënë duhet të jetë lexues i veçantë.

Në titujt e romaneve të Rexhep Qosjes ndihet mirë edhe ndërtekstorësia me ngjyresë stilistike, në të vërtetë ndërtekstorësia e tyre sugjeron realitetin jashtëtekstor, që do të thotë lidh fuqishëm tekstin me kontekstin, paralajmëron, madje shpesh tregon temën dhe mendimin bazë të tekstit dhe, njëkohësisht, qëndrimin e shkrimtarit, kurse me formën e me zgjedhjen e mjeteve gjuhësore na kujton a referon si tekste e titujt të ngjashëm, sidomos të veprave letrare botërore, ashtu edhe në tekstet me burim popullor. Në këtë funksion titujt e nëntitujt e prozave të Rexhep Qosjes veprojnë e funksionojnë si nyja ndërtekstore. Kjo i jep ndërtekstorësisë shtresë të veçantë simbolike dhe polisemike me efekt të rikujtesës, prandaj vështuar në këtë kontekst, mund të thuhet se ajo, ndërtekstorësia, nuk është veçori vetëm e teksteve të tij letrare, por edhe e parateksteve të tij.

Romanet e Rexhep Qosjes, të para nga ky aspekt, nuk janë vetëm art, por edhe njohje e gjerë dhe e thellë e jetës, çka provohet në semantikën, në gjuhën e në stilin, por edhe në ndërtekstorësinë e tyre me shumë elemente simbolike. Ndërtekstet me referenca kulturore, letrare, historike, filozofike nga autorë shqiptarë dhe autorë botërorë si në titujt e motot në fillim të romaneve ashtu edhe në nëntitujt e motot brenda romaneve, janë në numër shumë të madh. Ato flasin për autorin, për dijet e tij të gjera, për përvojën e pasur dhe për erudicionin e tij të thellë.

2. Tituj me shtresë polisemantike

Mund të thuhet se të gjithë titujt e romaneve të Rexhep Qosjes janë të shumëkuptimshëm. Kështu, fjala vjen, titulli i romanit “Një dashuri dhe shtatë faje”, si edhe titulli i romanit “Bijtë e askujt” janë tituj polisemikë dhe shquhen me simbolikë të gjerë e të pasur. Në boshtin semantik të të parit qëndron fati i mjekut Çerem Çapari, dhe jo vetëm i tij, që i vishen shtatë “faje” të mëdha përballë një dashurie të madhe ndaj Shqipërisë apo ndaj Hana Ujëmiri, fatkeqësisht me fund tragjik të kësaj të fundit, për çka lexuesit i mbetet të vendosë, kurse në

boshtin semantik të romanit të dytë “Bijtë e askujt” qëndron fati tragjik i shqiptarit dhe fati tragjik i atdheut të tij, që ka sjellë ndarjen e padrejtë të tokave shqiptare dhe, natyrisht, vdekjen tragjike të Tarik Saraçit, të birit të askujt në mesin e shumë të tillëve në tokat shqiptare e në botën e huaj. E të jesh bir i dikujt, por i pa atdhe, përkatësisht bir i askujt, të jesh pa atdhe, do të thotë të jesh i huaj dhe pa askënd, tamam ashtu siç do të thoshte Ernesto Sabato në librin e tij “Mbi heronjtë dhe varret” duke përshkruar Martinin: *“Të jetosh jashtë vendit tënd është njësoj pikëlluese sikur të banosh në një hotel të panjohur e të ftohtë: pa kujtime, pa drunjtë e njohur, pa fëmijëri, pa iluzione, sepse atdhe do të thotë fëmijëri e për këtë atij ndoshta më mirë do t’i flinte emërtimi mitër, sepse ajo të mbron, të ngrohë në momentet kur njeriun e mbyt vetmia dhe kur ndien të ftohtë rreth zemre.”* Për më tepër të jesh bir i askujt do të thotë të kesh fatin e fatkeqit dhe herë-herë edhe të viktimës. Fati i keq dhe fatkeqësia e Tarik Saraçit, që do t’i bjerë hise të përjetojë me viktimizimin e tij në kohën e diktaturës komuniste, duke vdekur pikërisht në kufirin që ndan tokat shqiptare, do të shndërrohet në simbol të gjithsecilit që do të ketë fatin e tij, fatin e birit të askujt, përkatësisht fatin e atij që ka mbetur pa plëng e atdhe, duke pasur dy të tillë virtualisht, në të vërtetë do të shndërrohet në metaforë të vdekjes ideologjike, të vdekjes simbolike dyfishe, përmes të copëtimit në dysh të trupit të tij.

Në anën tjetër edhe fatkeqësia e një vajze të re të një kohe më të re, Delina Dertit, fatkeqësi kjo e kohës së demokracisë, e demokracisë së shpërdorur shqiptare, si e quan shkrimtari edhe në publicistikën e tij të pasur, të shkruar e të botuar ndër, do të shndërrohet në një metaforë tjetër, po ashtu të fuqishme, të lirisë së dhunuar, që mund të gjejë shpjegim në pohimin e politikologut dhe historianit francez A. D. Tokvill në veprën e tij dy vëllimshme “Demokracia dhe Amerika”, botuar më 1835 dhe 1840, se: “demokracia moderne mund të krijojë artificialisht forma të reja tiranie”, që ka prodhuar edhe pyetjen e tij të famshme: “A mund të ketë liri në demokraci?”. Vërtet, a mund të ketë? Ky dyshim përshkon romanin polifonik e polisemantik “Bijtë e askujt” të Rexhep Qosjes të shprehur qartë edhe në titullin e tij pikëllues “Bijtë e askujt”.

3. Tituj me shtresë aludive

Konteksti tekstor, siç thuhet në studimet tekstore-diskursive, përcakton llojin e aluzioneve dhe mënyrën e aludimit, ashtu sikur që aluzionet shquajnë kontekstin e caktuar në kuptimin stilistik, intelektual, moral dhe socio-kulturor. Titujt e romaneve të Rexhep Qosjes sugjerojnë konotacione filozofike-morale, mitike dhe poetike: ata përmbajnë simbolikë e kuptim figurativ. Ata mund të quhen edhe burime të krijimit të aluzioneve. Kështu, në rrafshin tematik-përmbajtjesor, fjala vjen, titulli “Të fshehtat e treguara” aludon tema nga më të ndryshmet nga realiteti, historia, jeta shoqërore e politike dhe sidomos nga jeta private. Në rrafshin formal mund të përcaktohen raporte midis tekstit informues dhe tekstit referent të titujve dhe të nëntitujve të romanit sipas ngjashmërive formale, përputhjes së pjesërishme dhe ngjashmërive aludive. Mbështetur në konotacionet që përmbajnë, në shtresat filozofike-aludive, titujt e romaneve të Rexhep Qosjes mund t’i quajmë të kuptimshëm, interesantë, të pazakonshëm, tërheqës, të figurshëm dhe të ngarkuar me aluzione origjinale.

Shkrimtari Rexhep Qosja shfrytëzon në masë të madhe aluzionet, si mjet stilistik dhe si imazh artistik, prandaj mund të thuhet se disa figura stilistike me bazë alegorinë kanë zënë vend qendror në romanet e tij. Aluzionet e tij janë huazuar nga kultura e qytetërime të ndryshme, nga referencat biblike, nga mitologjia e lashtë ose e mesjetës, por edhe nga veprat letrare artistike, filozofike, politike, historike e të tjera. Me aluzionet, shkrimtari vendos paralele midis krijimtarisë së tij vetjake dhe veprave të njohura të shkruara para tij. Përmes aluzioneve ai ka shfrytëzuar imazhet ekzistuese apo edhe të dhëna të tjera kulturore-historike duke nënkuptuar ngjashmërinë e personazheve të tyre historike e mitologjike me personazhet e tij në njërën anë, kurse ngjashmërinë imagjinare të pamjeve e të ideve të tyre me pamjet e idetë e romaneve të tij, në anën tjetër. Kështu elemente të ndryshme mitike ose subjekte biblike janë shfrytëzuar në

të gjitha veprat e tij letrare dhe sidomos në dramat e tij. Fjala vjen për titullin e romanit “Një dashuri dhe shtatë faje” mund të thuhet se shkrimtari ka shfrytëzuar edhe shprehjen e njohur fetare “Shtatë mëkatet (fajet)” sipas krishterimit, islamit apo budizmit, përkatësisht sipas pikëpamjeve të Mahatma Gandit. Mund të thuhet, prandaj, se aluzionet e Rexhep Qosjes janë me prejardhje mitologjike, biblike, historike, letrare, filozofike, etike dhe estetike. Përmes tyre shkrimtari ka formësuar veprimin e romaneve të tij, ka zbuluar idetë e tij dhe imazhet e personazheve. Këto aluzione mund të nënkuptohen edhe në titujt, nëntitujt dhe sidomos në motot dhe në përfundimet e tyre.

Në vijim po paraqes tri lloje nëntitujsh sipas ngjyimeve kuptimore:

1.Nëntituj me aluzione dhe konotacione fetare ose me leksik fetar: Mëkati, Laneti, Jobi i vetmuar, Jobi i penduar nuk gjen paqe në këtë botë të zhugavtë - në romanin “Vdekja me vjen prej syve të tillë”; Profeti më kishte thënë, Kolona e pestë e shejtanit; E thashë dhe shpëtova shpirtin tim - në romanin “Një dashuri dhe shtatë faje”; Merrma shpirtin; Mëkato trimërisht; Mëshiomë mua mëkatarin; Jep bile pak mbasi ke shumë - në romanin - “Nata është dita jonë”; I luten zotit e rrinë me shejtanin; Hajmalia; Nuk të lë Zoti rehat - në romanin “Te fshehtat e treguara”; Ata te imzot Joni e imzot Joni te Shenjtëria - në novelën “I ringjalluri i penduar”, e të tjerë.

2.Nëntituj me ndërtekste me burim nga letërsia gojore, nga mitet a legjendat, ose të krijuara si formulime në formë aforizmash: *Herostati, Legjenda* - në romanin “Vdekja me vjen prej syve të tillë”; *Çka të mbjellësh do të korrësh; Kallakanxha dhe Ajsha e Zeqanit, Pas një të keqeje vijnë të tjerat; Sot edhe skraja mund të bëhet perandor, Kush troket i çilet* - në romanin “Një dashuri dhe shtatë faje”; *Mbylle gojën sa s'ta kanë mbyllur, Edhe sytë mashtrojnë* - në romanin “Të fshehtat e treguara”, e të tjerë.

3.Nëntituj me ndërtekste nga kultura të ndryshme, nga vepra letrare, nga mendime filozofike ose nga autorë të ndryshëm e të huaj: *Feneri i Diogjenit* - në romanin “Një dashuri dhe shtatë faje”; *Ç'më këshilloi Niçe; Unë jam Kazanova* - në romanin “Nata është dita jonë”; Titulli *Fjalori i fshehur* te romani “Një dashuri dhe shtatë faje” mund të ketë aluzionin filmin amerikan me të njëjtin titull *The Sleeping Dictionary*, të regjisorit dhe skenaristit Guy Jenkin (2003). Ndërkaq, teksti dhe titulli *Oktapodi i pandalshëm* në romanin “Te fshehtat e treguara” aludon në filmin serial më të njohur italian, i ndjekur shumë edhe në tv-të kombëtare nga publiku shqiptar, me titullin “*Oktapodi*”, që tematizon krimin, korrupsionin, nepotizmin e dukuri të tjera që lidhen me to dhe që janë karakteristike edhe për realitetin tonë të sotëm. Po kështu, nëntitulli “Te ferma e qenve” te novela “Ringjalluri i penduar” shkrimtari aludon në titullin e romanit “*Ferma e kafshëve*” të Xhorxh Oruellit.

Motot

Ashtu sikur në nëntitujt e tregimeve ose të ndarjeve të romaneve, edhe në motot, të vendosura në krye të romaneve, ose në krye të krerëve a të ndarjeve të veçanta, prej romanit të parë “Vdekja më vjen prej syve të tillë” e deri te romani i fundit i shkrimtarit “Të fshehtat e treguara”, gjejmë mjaft ndërtekste me burim fetar, të krishtera dhe islame, nxjerrë nga Bibla, Ungjilli, Libri i Jobit dhe Kurani. Po përmend këtu motot që shoqërojnë 13 tregimet e romanit “Vdekja më vjen prej syve të tillë” ose, fjala vjen, motot në krye të romanit “Nata është dita jonë”, si: “*Rrëfejua këto tregime, ndoshta do të mendojnë.* (Kurani, Araf, 175); *Çdo njeriu ia kam lidhur punën e tij rreth qafës së tij.* (Kurani, Isra, 13); *Syri yt është drita e trupit tënd.* (Ungjilli sipas Lukës, 11,34); *Kush ecën natën rrëzohet, sepse s'ka dritë në vete.* (Ungjilli sipas Gjoni, 11, 10), ose moton në krye të romanit të tij të fundit “Të fshehtat e treguara”: *Nuk mund t'i shërbehet edhe Zotit edhe Mamonit* (Ungjilli), që shoqërohet edhe me shtatë moto të tjera të disa autorëve botërorë.

Motot që shfrytëzon autori janë të shumëkuptimshme, simbolike dhe të figurshme. Ato përmbajnë mendime filozofike me forma tekstore dhe aforistike, ndërsa janë marrë nga vepra të shquara të letërsisë e të filozofisë botërore me autorë shkrimtarë, filozofë, historianë, politikanë, e të tjerë si këta: Rumi, Monteskie, Gilermo Kabrera Infante, Hulo Kortasari, Helderlini, Gynther Grasi, Shekspiri, Deni Didëro, Volteri, Artur Rembo, Halil Xhibrani, Migel de Unamunoja, Robert Muzili, Sharl Bodleri, Uiliem Fokneri, Horhe Luis Borges, Karlos Fuentes, Fridrih Niçej, Andre Berte, Filip Roti, Agata Kristi, Maks Frishi, Nikolo Makiaveli, Zhan Kokto, Zhorzh Bataji, Federiko Garsia Lorka, Umberto Ekoja, Oldos Haksli, Paolo Sorentinoja, Martin Luter Kingu, Javier Marias, Alfred Deblini, Mario Vargas Losa, Bertolt Brehti, Kormak Makarti, Kostas Mourselasi, Xhozef Konradi, por edhe nga parashikimet e Nostradamusit, nga Kanuni i Lekë Dukagjinit, nga Anonimi i shekullit VIII dhe shumë fjalë të urta popullore.

Elemente të tjera paratekstore

Në romanet e tij, shkrimtari ka futur edhe elemente të tjera paratekstore, siç janë parafjalët, që vendosen në krye të tekstit të romanit që kanë forma dhe tituj të ndryshëm, ashtu si edhe përfundimet që na dalin disa llojesh e me tituj të ndryshëm. Kështu, fjala vjen:

- romani “Vdekja më vjen prej syve të tillë” nuk ka fjalë hyrëse, por ka *Epilogun*;

-romani “Një dashuri dhe shtatë faje” fillon me *Fjalën paraprake të gjatë* dhe përfundon me *Fjalën përmbyllëse të shkurtër*;

-romani “Nata është dita jonë” nis me *Prologun*, kurse të tre librat brenda këtij romani shoqërohen me shënime shpjeguese që titullohen: *Kështu kishte filluar, Kështu kishte vazhduar, Kështu kishte përfunduar*, kurse përfundon me një tekst të shkurtër të titulluar *Fund*;

-romani “Bijtë e askujt” nuk ka fjalë hyrëse, por përmbillet me titullin *Pas përfundimit* ku paraqitet një baladë kushtuar nënës, me tekst dhe e notëzuar në pentagram;

- romani “Të fshehtat e treguara” nis me një tekst të shkurtër shpjegues, më pas paraqitet titulli *Kush sot e kush nesër* dhe vazhdon me *Parathënien* që mban titullin *Pse po e shkruaj këtë roman?*, kurse përfundon me një citat të Xhozef Konradit të nxjerrë nga libri “Lordi Xhim” dhe dy *Postskriptume* për Havanë dhe Bardhin - dy personazhet kryesore të romanit, që janë paratekste fiktive me të cilat autori/narratori u drejtohet lexuesve duke shpjeguar a interpretuar ngjarjet dhe kontekstin e romaneve të tij.

Vetëm novela “I ringjalluri i penduar” nuk përmban as parafjalë e as përfundim, sado parafjala paraqitet në fillimin, kurse përfundimi në mbarimin e saj.

Titujt e krerëve ose të ndarjeve të romaneve të Rexhep Qosjes kanë modalitete të ndryshme: disa nga titujt janë të ndarë nga teksti, disa shoqërohen me komente të autorit, disa shoqërohen me citime të shkrimtarëve, filozofëve e të figurave të shquara të kulturës botërore, disa krerë paraqiten me numra rreshtorë dhe shoqërohen me komente shpjeguese të përmbajtjes (“Bijtë e askujt”) ose me një tekst të shkurtër aforistik të autorit (“Vdekja më vjen prej syve të tillë”). Romanet kanë edhe ndarje të tjera që funksionojnë si *Shënime, Dosje, Dokumente arkivore, Fjalime, Raporte, Deklarata, Dëshmi, Procesverbale, Aktakuza, Fjalëmbrojtje, Kumtime, Njoftime, Përshëndetje, Letra kushtuese*, të cilat shpesh shoqërohen me shpjegime se kujt i drejtohen, *Biseda informative, Anketa të imagjinuara, Sinopsis, Testament, Mesazhe telefonike*. E të tjera.

Shënime janë llojesh të ndryshme për nga ana tematike e për nga ana strukturore dhe dallohen edhe sipas pozicionit që zënë në roman, edhe sipas kohës kur shkruhen - para ose pas ndonjë ndodhie apo vdekjeje, por edhe sipas shënuesve pragmatikë, të cilët mund të jenë të autorit, të narratorit, apo të redaktorit fiktiv. Ato janë shënime diskursive që lidhen ngushtë me tekstin, për dallim prej atyre shënimeve që kanë karakter eseistik, që nuk janë pak dhe që e shtojnë kur më pak e kur më shumë kërkësinë e lexuesit të romaneve, prandaj disa prej tyre mbahen gjatë

në mend, si fjala vjen: *Në trekëndëshin e mendimeve të mia, Metamorfoza* - në romanin “Vdekja më vjen prej syve të tillë”; *Hallet rreth titullit, Do të hidhërohen letërsia, lexuesit dhe juria* - në romanin “Bijtë e askujt”; *Arkivi – çfarë fjale, Përmendoret, Ballafaqimi i dy monumenteve, Dy faqe të historisë ballkanike, Stambolli, Përpyjet e teposhtë, Mandatet e përkohshme dhe mandatet e përhershme, Të gjitha vuajtjet e qafës, Abetarja e tyre, Gjysma dhe e-të pa zë* - në romanin “Të fshehtat e treguara”, *Përpyjet e teposhtë* - në novelën “I ringjalluri i penduar”.

Pos titujve, nëntitujve e motove, parathënieve, parafjalëve e epilogëve, shquhen edhe letrat që personazhet ia dërgojnë vetes, siç janë tri letrat e Zitës dhe po aq letra të Egzonit në romanin e tij të fundit “Të fshehtat e treguara”, që janë shpërndarë në hapësirat mes teksteve brenda katër ndarjeve të romanit.

Po kështu, ndeshim tekste zyrtare, por edhe tekste gjysmëzyrtare ose jo zyrtare me përmbajtje paratekstore, siç janë 24 dokumentet ku raportohet për përgjimet, që jepen në fund të romanit “Një dashuri dhe shtatë fajet”, që parakuptojnë dokumente, intervista të ndryshme, biseda të besueshme, biseda në hetuesi - paratekste këto që janë të rëndësishme për të kuptuar dhe interpretuar tekstin. Jo rrallë ato vendosen në hapësira midis teksteve ku zhvillohen strategji ndërligjërimore dhe citatësie, si fjala vjen, citatet mestekstore në romanin “Të fshehtat e treguara”. Këto elemente paratekstore, shkrimtari i ka aktualizuar si shënjes që zbulojnë kufijtë e tekstit, zakonisht të krijuara ose të marra nga tekstet jo letrare të stileve funksionale, por në funksion të stilizimit të llojeve të ndryshme tekstore.

Shkrimtari Rexhep Qosja, në romanet e tij, ka futur edhe elemente paratekstore në formën e letrave publike, por edhe të atyre private, që u drejtohen institucioneve e autoriteteve shtetërore, individëve të caktuar, të njohur e të panjohur, të gjallë ose të vdekur e të tjerëve, por edhe gazetave, revistave a institucioneve të ndryshme zyrtare e private. Po shquaj: njëmbëdhjetë letrat e Miran Bushatit, hulumtues i jetëshkrimit të Tarik Saraçit, dërguar të birit të tij, Gjinushit, pastaj *Korrespondencën midis Miran Bushatit dhe Arben Begesë* – në romanin “Bijtë e askujt”; letrën dërguar *Gazetës ditore Epoka e ardhur, Letra e tij e vetme dërguar përkthyesit, letra Shefit të Shërbimit të Brendshëm Shtetëror, letra Kryetarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, letra Shenjtërisë së tij Papa Françeskut, letra Gjergj Fishtës* – në romanin “Të fshehtat e treguara”. E të tjera. Këto elemente paratekstore, në të gjitha format e tyre, edhe pse në romanet e Rexhep Qosjes kanë vetëm funksion ndihmës, shtues e plotësues, dëshmojnë shumësinë ligjërimore të romaneve të tij, por edhe përcaktimin e tyre si romane moderne dhe postmoderne, sepse “letërsia postmoderne quhet ndryshe edhe *ars combinatoria*”⁷.

Përfundim

Regjistri me elemente paratekstore i romaneve të Rexhep Qosjes, që u paraqit këtu, është jo i plotë, sepse është shumë më i gjerë se kaq. Po përmendim vetëm disa nga këto elemente partatekstore që nuk u trajtuan këtu: ato që përmbajnë shënime gjuhësore, si fjalorë, tekste të autorit që përmbajnë plane për ndërtimin e romanit, për titullimin e tyre, skena drame e të tjera. Të gjitha këto elemente paratekstore janë ndihmëse dhe shtesa, në të vërtetë janë elemente që qëndrojnë midis tekstit dhe kontekstit, prandaj në rrafshin ligjërimesor ato janë përbërës metapozicionalë dhe metafunksionalë të romaneve të shkrimtarit Rexhep Qosja. Studimi i gjuhës dhe i stilit të këtyre romaneve ashtu si edhe interpretimi i tyre pa këto paratekste do të ishte i mangët, jo i plotë dhe jo i saktë.

Mund të thuhet në këtë përfundim se edhe me këta përbërës paratekstori që u trajtuan shkurtimisht këtu dëshmohet veçantia moderne, në të vërtetë postmoderne e romaneve të Rexhep Qosjes.

⁷ Agim Vinca, *Teori letrare*, “Libri shkollor”, Prishtinë, 2012, f. 362.